



Konferenca e Dytë Shkencore, 12-13 Dhjetor

## MENAXHIMI I ASETVE TË QËNDRUESHME DHE REKOMANDIMET E KLSH PËR NJËSITË E QEVERISJES VENDORE

Bajram Lamaj  
Drejtor Departamenti, KLSH  
e-mail: [blamaj@klsh.org.al](mailto:blamaj@klsh.org.al)

### ABSTRAKT

Dhënia e pavarësisë së veprimit dhe rritja e autonomisë vendore të njërive të qeverisjes vendore, ka sjellë në vëmendje domosdoshmërinë e vlerësimit të auditimeve që kryen KLSH në drejtim të administrimit dhe menaxhimit të asetëve të qëndrueshme që ato zotërojnë në territorin e tyre dhe krijimin e të mirave publike ndaj komunitetit. Në auditimet e kryera në disa bashki e komuna gjatë vitit 2013, rezultatet e pritura nuk janë arritur, por përkundrazi kemi shpërdorime e veprime korruptive që sjellin pasoja të pariparueshme juridike e institucionale, ku prona është kthyer në mjet fitimi për titullarët e këtyre njërive vendore duke i shitur e dhënë me qira pa pasur tagër ligjor, si dhe u ka munguar vizioni dhe përgjegjësia ligjore në ushtrimin e kompetencave, janë kthyer në “pronarë” të këtyre pronave.

Shfrytëzimi i tyre është deri tani pa efektivitet dhe eficiensa është shumë e ulët, pasi produktet e tyre nuk po transferohen si të mira për komunitetin e tyre . Në kuadrin e decentralizimit nga qeveria, janë transferuar të gjitha pronat dhe asetet e qëndrueshme që kanë në territoret e bashkive dhe komunave, por mungesa e shoqërimit të këtij transferimi me udhëzues të posaçëm apo me trajnime të punonjësve që do të punonin me administrimin dhe menaxhimin e tyre ka sjellë amulli. Trajtimi i këtyre resurseve jo në mënyre ligjore dhe si një burim i rritjes së të ardhurave të bashkisë/komunës dhe mos-administrimi i tyre sipas akteve ligjore në fuqi, na ka vënë përpara fakteve tepër shqetësuese , ku asetet janë “përvetësuar” nga persona që nuk kanë plotësuar kushtet e caktuara dhe nuk kanë njohuri apo kapacitete menaxhuese e administruese. Vetë KLSH, duke e vlerësuar maksimalisht rëndësinë e këtij problemi, ka kryer trajnim me audituesit e Departamentit të Auditimit të Pushtetit Vendor, Kontrollit Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme, duke evidentuar auditimet cilësore brenda KLSH, por kemi bashkëpunuar me Ministrinë e Mjedisit e thirrur si lektorë specialistë të fushës përkatëse për asetet (pyje, kullota dhe vepra ujore, etj) dhe ekspertë të jashtëm, për të ndihmuar audituesit në rritjen e aftësive profesionale të auditimit në këtë fushë, ku rekomandimet e KLSH po japin një impuls të ri në këtë drejtim,

### Fjalë kyçe:

*Decentralizim, autonomi vendore, efektivitet, shpërdorim*